

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

DREJTORIA E POLITIKËS MONETARE DHE E HULUMTIMIT



Treguesit më të rinj makroekonomikë
Rishikimi i gjendjes aktuale

Prill, 2022

Treguesit më të rinj makroekonomikë

Rishikimi i gjendjes aktuale – ndikimi ndaj politikës monetare

Rishikimi i gjendjes aktuale synon të japë një pasqyrë të të dhënave më të fundit makroekonomike (janar – mars 2022) dhe një krahasim me projeksionet më të fundit makroekonomike (tetor 2021). Kjo do të vërtetojë se si gjendja aktuale e ekonomisë korrespondon me lëvizjet e pritshme të variablave në ciklin e fundit të projeksioneve. Rishikimi është përqendruar në ndryshimet e supozimeve dhe të realizimeve të jashtme në variablat e brendshme dhe si janë pasqyruar këto ndryshime në mjedisin e drejtimit të politikës monetare.

Sipas vlerësimeve më të reja, mjedisi ekonomik botëror është më pak i favorshëm krahasuar me projeksionet e tetorit, me rishikime në rënie të projeksioneve për rritjen ekonomike globale, veçanërisht për vitin 2022. Arsyeja kryesore për këtë është shpërthimi i konfliktit ushtarak ruso-ukrainas dhe vendosja e sanksioneve të ashpra ekonomike kundër Rusisë, e cila pasqyrohet në rritjen e pasigurisë në nivelin global, uljen e besimit të subjekteve ekonomike, ndërprerjet e reja në zinxhirët e furnizimit dhe të tregtisë, rritjen e paqëndrueshmërisë në tregjet financiare dhe rritje e fortë të çmimeve të prodhimeve parësore energjetike dhe joenergjetike në bursat botërore, me efekte të theksuara në inflacionin në korniza globale. **Në të njëjtën kohë, pasiguria për rritjen e ardhshme globale vazhdon të jetë e lartë dhe rreziqet janë kryesisht në rënie.** Aktualisht, përshkallëzimi i mëtejshëm dhe zgjatja e mundshme e konfliktit ushtarak midis Rusisë dhe Ukrainës, paralelisht me efektet e sanksioneve aktuale dhe përkeqësimin e mundshëm të mëtejshëm të marrëdhënieve ekonomike midis Perëndimit dhe Rusisë, është burimi kryesor i rreziqut për rritjen globale. Në të njëjtën kohë, vazhdojnë të ekzistojnë rreziqet që lidhen me ecurinë e mëtejshme të pandemisë dhe mundësinë e zgjatjes së saj për shkak të shfaqjes së llojeve të reja të virusit. Nga rreziqet e tjera, shtrëngimi i mundshëm më i shpejtë i politikës monetare në vendet e zhvilluara mund të ndikojë negativisht në stabilitetin financiar dhe pozicionet fiskale të vendeve me rritje të shpejtë me borxhe të larta, me pasoja në perspektivën ekonomike globale. Sa u përket **zhvillimeve ekonomike në Eurozonë**, si partneri ynë kryesor tregtar, treguesit nga sondazhet e subjekteve ekonomike për muajin mars janë më pak të favorshëm, krahasuar me një muaj më parë, me vlerësime më të dobëta për aktivitetin konsumator, sektorin industrial dhe shitjet me pakicë për shkak të fillimit të konfliktit ushtarak ruso-ukrainas, duke treguar për një rritje më të dobët ekonomike në tremujorin e parë të vitit 2022. Në mënyrë të ngjashme, hulumtimi i sondazhit në Gjermani, partneri ynë i vetëm tregtar më i rëndësishëm, tregon për një përkeqësim të ndjeshëm të situatës në ekonomi në mars, krahasuar me periudhën para fillimit të luftës në Ukrainë, me prirje më pak të favorshme në pothuajse të gjithë sektorët, që pasqyrohet në mënyrë të pafavorshme në vlerësimet për rritjen në tremujorin e parë. Në këtë sfond, kushtet e tregut të punës në Eurozonë vazhdojnë të përmirësohen, ndërkohë që sipas raporteve fillestare, shkalla e papunësisë në shkurt ishte në nivel të ri historik të ulët prej 6,8%¹ (6,9% në janar dhe 7,1% në tremujorin e katërt të vitit 2021). Sa i përket inflacionit në Eurozonë, të dhënat tregojnë një vazhdimësi të lëvizjeve në rritje edhe në mars, ku rritja e çmimeve ishte në nivel të ri rekord prej 7,5%² në bazë vjetore (5,9% në shkurt), në kushtet e rritjes së përsheptuar të të gjithë komponentëve, veçanërisht të komponentit energjetik. Sipas vlerësimeve të fundit, në vitin 2022 pritet që **norma e interesit të huaj EURIBOR** me maturim njëmuor të jetë në të njëjtin nivel si në projeksionin e tetorit, ndërsa për vitin 2023 është bërë një korrigjim i ndjeshëm në rritje, në përputhje me pritshmëritë e tregut, për një normalizim gradual të politikës monetare të BQE-së, duke filluar nga fundi i këtij viti.

Nga këndvështrimi i treguesve të veçantë sasiorë për mjedisin e jashtëm, që janë të rëndësishme për ekonominë maqedonase, kërkesa e huaj efektive për vitin 2022 është rishikuar në rënie, ndërsa për vitin 2023 është rishikuar lehtësisht në rritje, krahasuar me vlerësimet

¹ I referohet periudhës nga prilli 1998, kur publikohen të dhënat mujore për shkallën e papunësisë në Eurozonë.

² I referohet periudhës nga janari 1997, kur publikohen të dhënat mujore për shkallën e inflacionit në Eurozonë.

e tetorit. Nga ana tjetër, rishikime më të theksuara në rritje janë bërë në **inflacionin efektiv të huaj** gjatë periudhës së projeksionit, veçanërisht për vitin 2022. Sa i përket **kursit valutor EUR/USD**, dollari amerikan do të mbivlerësohet ndjeshëm më shumë në vitin 2022 dhe do të nënçmohet pak më shumë në vitin 2023, krahasuar me vlerësimet e tetorit. **Projeksionet e fundit për çmimet e produkteve primare në bursat botërore janë rishikuar në rritje për vitin 2022, ndërsa për vitin 2023 korrigjimet janë kryesisht në rënie, krahasuar me vlerësimet e tetorit.** Kështu, për vitin 2022 pritet një rritje dukshëm më e lartë e çmimeve të produkteve primare, ndërsa për vitin 2023 pritet që pjesa më e madhe e tyre të ketë një rënie më të fortë të çmimeve. Megjithatë, lëvizjet dhe vlerësimet e çmimeve të produkteve primare janë jashtëzakonisht të ndryshueshme dhe aktualisht janë nën ndikimin e fuqishëm të zhvillimeve në lidhje me konfliktin ushtarak ruso-ukrainas, që krijon pasiguri të madhe për dinamikën e ardhshme të tyre dhe efektet në ekonominë vendase, veçanërisht në afat të shkurtër.

Krahasimi i treguesve të fundit makroekonomikë të ekonomisë vendase me dinamikën e tyre të parashikuar brenda ciklit të projeksioneve të tetorit, tregon devijime të caktuara në segmente të caktuara të ekonomisë. Sipas vlerësimeve të publikuara të PBB-së, në tremujorin e katërt të vitit 2021, PBB-ja reale u rrit për 2,3% në bazë vjetore (nga 3% në tremujorin e mëparshëm). Me këto realizime, rritja e mëtejshme e ekonomisë vendase vazhdoi, por më ngadalë, gjatë përhapjes së valës së pestë të pandemisë së shoqëruar me llojin "omicron" të Kovid-19, ndërprerjen e zinxhirëve të furnizimit global dhe shfaqjen e efekteve të para të ndërprerjes së tregut të energjisë. Duke parë të gjithë vitin 2021, ekonomia shënon një rritje reale prej 4%, që është brenda pritshmërive nga projeksioni i tetorit (3,9%). Të dhënat me frekuencë të lartë për periudhën janar - shkurt 2022 japin sinjale të përziera, duke treguar për realizime më të mira në industri, ulje të mëtejshme të aktivitetit në ndërtimtari dhe rritje reale vjetore të qarkullimit në totalin e tregtisë, por më mesatare. Me përshkallëzimin ushtarak midis Rusisë dhe Ukrainës që nga fundi i shkurtit, i cili ka efekte negative në ekonominë globale, janë përkeqësuar tashmë zinxhirët globalë të furnizimit dhe tregu i energjisë i ndërprerë, si dhe besimi i subjekteve ekonomike, por edhe perspektivat për ekonominë vendase. **Sa u përket ndryshimeve në çmimet e konsumit, shkalla vjetore e inflacionit në periudhën janar-mars 2022 është 7,7%, që është një realizim më i lartë, krahasuar me parashikimet e fundit.** Dinamika vjetore e inflacionit është mbi të gjitha pasqyrim i rritjes së çmimeve të energjisë dhe të produkteve ushqimore, si rezultat i rritjes së lartë të çmimeve të importit, si dhe një përshpejtim i caktuar i rritjes vërehet edhe në rastin e inflacionit bazë. Trysnitë e çmimeve vazhdojnë të rrjedhin kryesisht nga faktorët e ofertës që lidhen me ndryshimet e çmimeve në tregjet globale, të cilat nga ana e tyre janë të lidhura me ndërprerjet e tregut të energjisë dhe ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit global. Duke pasur parasysh inflacionin e realizuar që është mbi projeksionin dhe pritshmëritë për dinamikën e ardhshme të çmimeve të importit që janë korrigjuar në kahe në rritje, edhe rreziqet për projeksionin e inflacionit janë në rritje. Në të njëjtën kohë, në kushtet e lëkundjeve të konsiderueshme në lëvizjen e çmimeve botërore të produkteve parësore, edhe në baza ditore, të shkaktuara nga lufta në Ukrainë dhe sanksionet kundër Rusisë të vendosura nga shumica e vendeve në botë, lëvizja e tyre është vështirë të parashikohet, ndaj theksohet pasiguria në lidhje me lëvizjet e ardhshme të çmimeve.

Rezervat valutore në fund të marsit 2022 vazhdojnë të jenë në nivele të larta dhe janë në zonën e sigurt. Të dhënat më të fundit në dispozicion për sektorin e jashtëm tregojnë një deficit tregtar pak më të lartë se sa pritej për tremujorin e parë të vitit, ndërsa të dhënat për operacionet valutore për tremujorin e parë të vitit 2022 tregojnë hyrje neto të realizuara nga transferet private që janë më të ulëta se sa pritej për tremujorin e parë të vitit 2022, sipas projeksionit të tetorit.

Sa u përket **lëvizjeve në sektorin monetar**, të dhënat e shkurtit tregojnë një rënie të vogël mujore të totalit të **depozitave** prej 0,4% (rënie prej 0,8% në janar), që është tërësisht rezultat i rënies mujore të depozitave të korporatave, me rritjen mesatare të depozitave të amvisërive. Nga aspekti valutor, rënia e gjithsej depozitave është rezultat i rënies së depozitave në denarë (përfshirë paratë e depozitave), me një rritje mesatare të depozitave në valuta. Në bazë vjetore, gjithsej depozitat në shkurt ishin më të larta për 5,8%, me një rritje të projektuar për tremujorin e parë të

vitit 2022 prej 6,9%. **Kreditë** totale e sektorit privat është rritur për 0,9% në muajin shkurt, e cila vjen kryesisht nga kreditë e ndërmarrjeve, me një rritje të njëkohshme më mesatare të kredive të amvisërive. Sipas strukturës valutore, rritja është thuhetse njëlojt si rezultat i kredive në valutë vendase dhe të huaja. Në bazë vjetore, rritja e totalit të kredive në shkurt ishte 8,9%, ndërsa rritja e projektuar për tremujorin e parë të vitit 2022 ishte 7,1%, në përputhje me projeksionin e tetorit.

Në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në periudhën janar - shkurt 2022 u realizua deficiti prej 6.855 milionë denarë. Deficiti buxhetor financohet më së shumti duke shfrytëzuar depozitat e shtetit në Bankën Popullore dhe me huamarrjen e shtetit në tregun vendas. Deficiti buxhetor i realizuar për dy muajt e parë përfaqëson 20,4% të deficitit të projektuar në Buxhetin e vitit 2022.


Treguesit më të fundit makroekonomikë dhe vlerësimet e fundit tregojnë për rritjen e rreziqeve në segmente të caktuara të ekonomisë dhe në drejtime të ndryshme, që krijon një mjedis kompleks makroekonomik. Rezervat valutore mbahen në nivelin e duhur dhe në zonën e sigurt. Sa i përket rritjes, realizimet në vitin 2021 janë në përputhje me ato të projektuara dhe të dhënat në dispozicion me frekuencë të lartë për aktivitetin ekonomik për dy muajt e parë të këtij viti vazhdojnë të jenë relativisht të favorshme dhe tregojnë për rritjen e mëtejshme të ekonomisë. Por perspektiva e rritjes shoqërohet me rreziqe të theksuara në rënie, në përputhje me zhvillimet aktuale ushtarake që filluan në fund të shkurtit dhe sanksionet ekonomike të vendosura ndaj Rusisë dhe ndikimin e tyre të fortë në tregjet e mallrave, zinxhirët e furnizimit dhe besimin. Nga ana tjetër, realizimet inflacioniste në tremujorin e parë të vitit po ecin lart dhe mbi ato të projektuara, nën trysninë e çmimeve gjithnjë e më të larta të importit të karburanteve dhe të ushqimeve, të cilat gradualisht po fillojnë të transferohen në inflacionin bazë, për shkak të të cilave rreziqet në segmentin e çmimeve janë në rritje. Po ashtu, lëvizja e çmimeve në bursa është jashtëzakonisht e ndryshueshme, e pasigurt dhe nën ndikimin e fuqishëm nga zhvillimet ushtarake. Në sektorin monetar, rritja vjetore e kredive është aktualisht mbi atë të projektuar për tremujorin e parë të vitit 2022, në përputhje me projeksionin e tetorit, dhe rritja e depozitave është pak më mesatare se sa ishte parashikuar.

Vlerësime më pak të favorshme për mjedisin e jashtëm

Vlerësimet më të fundit të treguesve sasiore të mjedisit të jashtëm të vendit tonë, në lidhje me ciklin aktual të projeksioneve makroekonomike, tregojnë një perspektivë më pak të favorshme për kërkesën e huaj dhe trysni më të larta të çmimeve të importeve, krahasuar me projeksionet e tetorit. Sipas pritshmërive më të fundit, rritja e **kërkesës së huaj efektive** do të jetë 2,9% këtë vit, ndërsa një rritje e ngjashme prej 2,8% pritët në vitin e ardhshëm. Krahasuar me pritshmëritë e tetorit, rritja e kërkesës së huaj për dy vitet së bashku është rishikuar për 0,8 pikë përqindjeje, me një rishikim në rënie të rritjes në të gjithë partnerët kryesorë tregtarë dhe kryesisht në Gjermani, për të cilën pritët një rritje prej 2,5% dhe 2,6% në 2022 dhe 2023 në mënyrë përkatëse (4,4%, përkatësisht 1,8% në tetor). Sa i përket **inflacionit të huaj efektiv**, rishikimet janë në kahe në rritje, veçanërisht për vitin 2022, me pritshmëri për rritje më të lartë të çmimeve në të gjitha vendet partnere të importit. Inflacioni i jashtëm efektiv këtë vit do të arrijë 5,7% (2,3% në tetor), dhe në vitin 2023 do të ngadalësohet në 3,2% (1,9% në tetor).


Селектирани макроекономски показатели ^{/1}					2020					2021										2022											
	2016	2017	2018	2019	Кв.1	Кв.2	Кв.3	Кв.4	2020	јан.	фев.	март	Кв.1	апр.	мај	јун.	Кв.2	јул.	авг.	сеп.	Кв.3	окт.	ное.	дек.	Кв.4	2021	јан.	фев.	мар.	Кв.1	
I. Реален сектор индикатори																															
Бруто домашен производ (годишна реален раст) ^{/2}	2,8	1,1	2,9	3,9	-1,3	-16,4	-5,9	-0,8	-6,1				-1,8				13,4				3,0				2,3	4,0					
Индустриско производство ^{/3}																															
стапка на промена (годишна)	3,4	0,2	5,4	3,7	-3,7	-25,0	-7,5	-2,3	-9,5	-13,5	-12,2	7,6	-6,1	46,1	16,5	9,5	22,2	-0,6	-1,4	-8,0	-3,5	-6,5	4,7	-4,9	-2,3	1,4	0,7	6,3			
кумулятивна просечна стапка	3,4	0,2	5,4	3,7	-3,7	-14,6	-12,1	-9,5	-9,5	-13,5	-12,8	-6,1	-6,1	3,7	6,0	6,6	6,6	5,4	4,5	2,9	2,9	1,8	2,1	1,4	1,4	1,4	0,7	3,6			
Инфлација ^{/4}																															
ЦПИ Инфлација (годишна) ^{/5}	-0,2	2,4	0,9	0,4	0,6	0,5	1,5	2,2	2,3	1,9	1,9	2,1	2,0	2,7	3,0	2,7	2,8	3,4	3,6	3,7	3,5	4,1	4,8	4,9	4,6	4,9	6,7	7,6	8,8	7,7	
ЦПИ Инфлација (кумулятивна просечна)	-0,2	1,4	1,5	0,8	0,6	0,5	0,9	1,2	1,2	1,9	1,9	2,0	2,0	2,2	2,3	2,4	2,4	2,5	2,7	2,8	2,8	2,9	3,1	3,2	3,2	3,2	6,7	7,1	7,7	7,7	
Базична инфлација (кумулятивна просечна)	1,3	2,3	1,5	0,5	0,7	0,6	0,7	0,9	0,9	1,8	1,7	1,6	1,6	1,6	1,7	1,8	1,8	2,0	2,0	2,1	2,2	2,2	2,2	2,3	2,4	2,4	3,2	3,7	4,2	4,2	
Базична инфлација (годишна) ^{/5}	1,0	2,8	1,4	-0,3	0,7	0,5	0,8	1,6	1,9	1,8	1,6	1,5	1,6	1,7	1,8	2,4	2,0	3,0	2,8	2,9	2,9	2,9	3,1	2,9	3,0	2,9	3,2	4,3	5,2	4,2	
Работна сила																															
Стапка на невработеност	23,7	22,4	20,7	17,3	16,2	16,7	16,5	16,1	16,4				16,0				15,9				15,7				15,2	15,7					
II. Фискален сектор индикатори																															
(Централен Буџет и Буџети на фондови)																															
Вкупни буџетски приходи	169.356	179.673	188.505	203.822	46.484	40.923	48.585	53.562	189.554	14.806	16.423	17.667	48.896	19.271	15.726	17.410	52.407	20.190	17.132	19.151	56.473	20.055	19.133	21.057	60.245	218.021	16.767	18.852			
Вкупни буџетски расходи	185.407	196.561	200.071	217.445	53.895	59.458	58.511	71.557	243.421	18.995	19.176	19.101	57.272	19.242	20.759	21.206	61.207	23.338	22.489	19.538	65.365	18.739	24.399	29.924	73.062	256.906	20.226	22.248			
Буџетско салдо (готовинска основа)	-16.051	-16.888	-11.566	-13.623	-7.411	-18.535	-9.926	-17.995	-53.867	-4.189	-2.753	-1.434	-8.376	29	-5.033	-3.796	-8.800	-3.148	-5.357	-387	-8.892	1.316	-5.266	-8.867	-12.817	-38.885	-3.459	-3.396			
Буџетско салдо (% од БДП) ^{/1}	-2,7	-2,7	-1,8	-2,0	-1,1	-2,8	-1,5	-2,7	-8,2	-0,6	-0,4	-0,2	-1,2	0,0	-0,7	-0,5	-1,2	-0,4	-0,7	-0,1	-1,2	0,2	-0,7	-1,2	-1,8	-5,4	-0,4	-0,4			
III. Финансиски индикатори^{/6}																															
Парична маса (M4), годишна стапка на раст	6,2	5,1	11,8	9,3	8,9	9,8	6,9	6,9	6,9	7,7	8,2	7,9	7,9	7,1	7,0	6,7	6,7	7,1	9,6	8,2	8,2	7,8	7,6	7,0	7,0	7,0	6,5	5,3			
Вкупни кредити, годишна стапка на раст	-0,1	5,4	7,3	6,0	5,8	6,6	7,3	4,7	4,7	4,6	4,4	5,2	5,2	5,7	5,6	5,1	5,1	5,2	6,4	6,3	6,3	6,7	7,7	8,3	8,3	8,3	8,4	8,9			
Вкупни кредити на население	7,0	9,2	10,3	10,5	10,1	8,8	9,5	8,0	8,0	7,4	7,1	8,1	8,1	8,9	8,8	8,7	8,7	8,0	7,9	7,5	7,5	7,3	7,7	7,8	7,8	7,8	7,8	7,8			
Вкупни кредити на претпријатија	-5,3	2,3	4,5	1,9	1,8	4,6	5,2	1,1	1,1	1,6	1,4	2,1	2,1	2,3	2,1	1,2	1,2	2,0	4,5	4,8	4,8	5,6	7,4	8,7	8,7	8,7	9,0	10,0			
Вкупни депозити (со депозитни пари), годишна стапка на раст ^{/7}	6,1	5,0	12,1	9,0	7,9	8,4	5,4	5,7	5,7	6,1	6,9	7,3	7,3	6,8	7,1	6,7	6,7	6,8	9,9	8,2	8,2	7,9	7,9	7,5	7,5	7,5	7,2	5,8			
Вкупни депозити на население	2,5	6,1	9,5	7,9	8,6	8,7	6,1	4,6	4,6	4,7	5,2	5,2	5,2	4,7	4,8	4,2	4,2	4,3	7,4	6,9	6,9	7,2	7,1	7,1	7,1	7,1	6,8	6,0			
Вкупни депозити на претпријатија	13,4	2,1	9,5	14,6	12,5	11,2	8,0	10,1	10,1	12,0	13,7	12,9	12,9	14,3	16,0	16,7	16,7	17,1	20,2	15,6	15,6	13,9	13,7	11,6	11,6	11,6	11,5	8,3			
Каматни стапки ^{/8}																															
Каматна стапка на БЗ (крај на месец/квартал/година)	3,75	3,25	2,50	2,25	1,75	1,50	1,50	1,50	1,50	1,50	1,50	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	1,25	
Активни каматни стапки																															
денарски	7,0	6,6	6,1	5,6	5,3	5,3	5,1	5,1	5,2	5,0	5,0	5,0	5,0	5,0	4,9	4,9	4,9	4,8	4,8	4,8	4,8	4,8	4,7	4,7	4,7	4,9	4,6	4,6			
девизни (агрегатна, за девизни и денарски со девизна клаузула)	5,7	5,3	4,9	4,6	4,4	4,3	4,3	4,2	4,3	4,2	4,2	4,1	4,2	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,1	4,0	4,1	4,1	4,0	4,0			
Пасивни каматни стапки																															
денарски	2,5	2,2	2,0	1,9	1,6	1,5	1,4	1,4	1,5	1,3	1,3	1,3	1,3	1,3	1,2	1,2	1,2	1,2	1,1	1,1	1,1	1,1	1,1	1,1	1,1	1,2	1,0	1,0			
девизни (агрегатна, за девизни и денарски со девизна клаузула)	1,0	0,9	0,8	0,8	0,7	0,6	0,6	0,6	0,6	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,4	0,4			
IV. Надворешен сектор индикатори																															
Биланс на тековна сметка (во милиони ЕУР)																															
Биланс на тековна сметка (% од БДП)	-275,5	-102,9	-7,12	-368,3	-155,68	-90,0	-50,6	-69,9	-366,2	29,6	-67,4	-15,1	-53,0	-112,9	-5,4	3,0	-115,3	90,8	-7,6	15,8	99,1	-62,6	-109,3	-174,6	-346,5	-415,7					
Трговски биланс (во милиони ЕУР) ^{/9}	-18,0	-18,1	-16,9	-17,9	-4,75	-3,6	-4,9	-16,7	-0,8	1,7	-2,0	-4,5	-2,3	-1,8	-1,9	-6,0	-1,9	-2,0	-1,4	-5,3	-2,1	-2,2	-3,0	-7,4	-23,1	-2,1	-2,4				
Трговски биланс (% од БДП)	-18,0	-18,1	-16,9	-17,9	-4,75	-3,6	-4,9	-16,7	-0,8	1,7	-2,0	-4,5	-2,3	-1,8	-1,9	-6,0	-1,9	-2,0	-1,4	-5,3	-2,1	-2,2	-3,0	-7,4	-23,1	-2,1	-2,4				
Увоз (во милиони ЕУР)	-6.176,5	-6.834,9	-7.676,3	-8.441,0	-1.426,9	-1.996,8	-2.252,0	-7.594,5	-623,7	-746,6	-820,5	-2.190,8	-891,6	-753,7	-807,6	-2.452,9	-805,2	-804,4	-725,7	-2.335,3	-837,2	-878,1	-943,9	-2.659,3	-9.638,3	-808,2	-980,0				
Извоз (во милиони ЕУР)	4.390,3	5.018,7	5.872,4	6.433,3	1.407,72	1.042,6	1.606,2	1.721,4	5.777,9	527,3	545,2	588,6	1.661,2	1.610,	547,1	583,8	1.747,8	587,1	566,2	564,5	1.717,7	588,9	614,3	592,7	1.795,9	6.922,6	546,0	670,4			
стапка на раст на увозот (годишна)	6,5	10,7	12,3	10,0	-36,0	-31,9	-3,4	-1,4	-10,0	5,5	3,7	35,1	14,2	138,5	65,5	35,1	71,9	12,3	33,3	7,3	17,0	9,5	26,3	19,1	18,1	29,9	29,6	31,3			
стапка на раст на извозот (годишна)	7,4	14,3	17,0	9,6	-8,25	-35,9	-1,7	5,1	-10,0	15,4	4,9	36,6	18,0	192,0	61,2	18,7	67,6	13,2	13,0	-3,8	6,9	-1,4	6,2	8,7	4,3	19,8	3,6	23,0			
Странски директни инвестиции (во милиони ЕУР)	316,9	180,0	603,7	363,3	123,24	-8,6	-8,2	48,3	154,7	-42,4	23,7	15,2	-3,5	102,5	31,3	83,2	217,0	-16,4	16,5	24,5	24,6	60,7	50,4	86,1	197,1	435,2					
Надворешен долг																															
Бруто надворешен долг (во милиони ЕУР)	7.216,6	7.372,5	7.843,7	8.154,4	8295,5	8770,9	9068,8	8536,1	8.536,1				9.809,7				10.171,6				9.870,4				9.547,3	9.547,3					
јавен сектор	3.445,3	3.461,8	3.756,2	3.836,6	3816,5	4460,3	4644,6	4301,4	4.301,4				5.202,9				5.458,7				5.157,3				4.802,0	4.802,0					
јавен сектор/БДП (во %)	35,7	34,5	35,1	34,2	35,4	41,4	43,1	40,0	40,0				44,3				46,5				43,9				40,9	40,9					
приватен сектор	3.771,2	3.910,7	4.087,5	4.317,8	4478,9	4310,5	4424,1	4.234,6	4.606,7				4.606,7				4.712,9				4.713,1				4.745,4	4.745,4					
Бруто надворешен долг/БДП (во %)	74,7	73,4	73,3	72,7	77,0	81,5	84,2	79,3	79,3				83,6				86,7				84,1				81,4	81,4					
Бруто девизни резерви (во милиони ЕУР)^{/10}																															
	2.613,4	2.336,3	2.867,1	3.262,6	3.017,3	3.639,7	3.480,2	3.359,8	3.359,8	3.335,7	3.298,0	3.939,2	3.939,2	4.003,5	4.019,8	4.031,1	4.031,1	3.547,6	3.691,6	3.690,7	3.690,7	3.650,4	3.571,4	3.643,3	3.643,3	3.643,3	3.465,1	3.382,4	3.272,5	3.272,5	

Странска ефективна побарувачка
(годишни промени во %)




Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.

Странска ефективна инфлација
(годишни стапки во %)



Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.

Курс евро/САД-долар



Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.

Në projeksionet e fundit të **kërkesës së huaj efektive**, vlerësimet për vitin 2022 janë rishikuar në rënie dhe ato për vitin 2023 janë rishikuar në rritje. Aktualisht pritet që rritja e kërkesës së huaj efektive në vitin 2022 të jetë 2,9% (4,3% në tetor), ndërsa për vitin 2023 rritja do të jetë 2,8% (2,2% në tetor). Rishikimet e këtilla janë kryesisht rezultat i vlerësimeve për aktivitetin më të ulët ekonomik në Gjermani³ më 2022, kurse më të lartë më 2023, krahasuar me vlerësimet e tetorit.

Sa i përket inflacionit të huaj efektiv, është bërë një rishikim në rritje për të gjithë periudhën e projeksionit, veçanërisht në vitin 2022. Kështu, rritja e inflacionit të huaj efektiv pritet aktualisht të jetë 5,7% dhe 3,2% në vitin 2022 dhe 2023 në mënyrë përkatëse, kundrejt 2,3% dhe 1,9% në tetor. Rishikimi në rritje vjen si pasojë e pritshmërive për inflacion më të lartë nga të gjithë partnerët tanë të importit, ku kontributin më të madh në rishikimin në rritje mesatarisht për dy vitet e kanë dhënë Gjermania, Bullgaria dhe Polonia.

Sa i përket **kursit valutor euro/dollar amerikan**, një rishikim më i rëndësishëm në rritje u bë për vitin 2022, me ç'rast pritet aktualisht një forcim më i madh i vlerës së dollarit amerikan ndaj euros. Kjo zhvendosje është kryesisht një pasqyrim i pritshmërive për shtrëngimin më të shpejtë monetar nga FED-i, në kushtet e realizimeve solide në tregun e punës në SHBA dhe inflacionit relativisht të lartë, si dhe rritjes së interesit të investuesve për dollarin amerikan për shkak të pasigurisë së lartë, për shkak të konfliktit ushtarak në Ukrainë. Nga ana tjetër, për vitin 2023, korrigjimi është në kahen në rënie, ku zhvlerësimi i dollarit amerikan vazhdon të pritët në raport me euron.

³ Rritja e Gjermanisë projektohet në 2,5% dhe 2,6% më 2022 dhe 2023 në mënyrë përkatëse, kundrejt 4,4% dhe 1,8% në tetor.

(квартален просек, евра/барел)



Në vlerësimet më të reja për **çmimin e naftës**⁷, për vitin 2022, u bë një rishikim në rritje, me një rritje dukshëm më të lartë të çmimeve se sa ishte parashikuar në tetor, që po parashikohet aktualisht. Ky korigjim është kryesisht për shkak të përshkallëzimit të konfliktit në Ukrainë, i cili shkaktoi mungesë në anën e furnizimit për shkak të vendosjes së ndalesës së importit të naftës ruse, nga Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar, duke ruajtur më tej vendimin për rritjen mesatare të prodhimit mujor të naftës nga vendet anëtare të OPEC+. Nga ana tjetër, për vitin 2023 u bë një rishikim në rënie, me një rënie aktualisht më të madhe të çmimit të naftës.

(годишни промени во %)




Për çmimet e nikelit dhe bakrit, rishikimet janë në rritje për të gjithë periudhën e projektimit, veçanërisht në vitin 2022. Lëvizjet në rritje të çmimeve të këtyre metaleve, veçanërisht të nikelit, vijnë si pasojë e pritshmërive për mungesa në anën e ofertës, për shkak të ndërprerjeve të mundshme të furnizimit nga Rusia, në kushtet e rritjes së kërkesës nga industria e makinave elektrike.

Цени на пченицата и пченката во евра
(годишни промени во %)



Rishikime në rritje për vitin 2022 u bënë edhe në **çmimet e produkteve ushqimore**. Në fakt, sipas vlerësimeve të fundit, pritet rritje më e theksuar e çmimit të grurit dhe rritje e çmimit të misrit, në vend të uljes. Lëvizjet në rritje të këtyre çmimeve janë për shkak të ndërprerjeve të mundshme në kanalet e furnizimit në Detin e Zi për shkak të konfliktit ushtarak midis Ukrainës dhe Rusisë⁴. Për vitin 2023, rishikimet janë në rënie, me një rënie aktualisht më të madhe të çmimeve të grurit dhe misrit, krahasuar me parashikimet e tetorit.


Едномесечен Еурибор
(квартален просек, во %)




Në rastin e EURIBOR-it njëmuoj, rishikimet janë në rritje në të gjithë periudhën e projeksionit, veçanërisht në vitin 2023. Në të njëjtën kohë, pritet që EURIBOR-i njëmuoj në vitin 2022 të mbetet në zonën negative dhe mesatarisht -0,47% (-0,51% në tetor), ndërsa duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2023 do të kalojë në zonës pozitive dhe mesatarisht për të gjithë vitin do të jetë 0,27% (-0,4% në tetor). Lëvizjet e këtilla janë kryesisht për shkak të pritshmërive të investuesve për një shtrëngim gradual të politikës monetare nga BQE-ja në fund të këtij viti.

⁴ Ukraina dhe Federata Ruse së bashku përbëjnë rreth 30% të eksporteve globale të grurit. Porti i Odessës dhe Deti i Zi shërbejnë si kanalet kryesore për dërgesat ndërkombëtare të grurit nga Ukraina, ndërsa vendi është gjithashtu ndër eksportuesit kryesorë të elbit, misrit, lulediellit dhe farave të tjera vajore. Burimi: Publikimi i FAO: AMIS, Mars 2022.

Стапка на инфлација
(годишни придонеси во вкупната инфлација, во п.п.)



Придонеси кон годишната стапка на инфлацијата (во п.п.)




Në mars të vitit 2022, **çmimet e konsumit vendas** u rritën për 1,6% në bazë mujore (1% në muajin paraardhës), si rezultat i rritjes së çmimeve në të tre komponentët kryesorë. Në të njëjtën kohë, rritja e çmimeve të ushqimeve ka një kontribut të rëndësishëm në rritje, me një rritje të ndjeshme të çmimeve në kategorinë e "bukës dhe produkteve të drithërave", e ndjekur nga rritja në kategorinë e "qumështit, djathit dhe vezëve", çmimet e mishit dhe çmimet e frutave. Kontribut pozitiv në mars kishin edhe çmimet e energjisë, të cilat vazhdojnë të shënojnë rritje për shkak të çmimeve më të larta të karburanteve, në përputhje me rritjen e çmimeve të derivateve të naftës në tregjet botërore nën ndikimin e luftës aktuale ruso-ukrainase. Trysnitë nga rritja e çmimeve të importit u zbutën pjesërisht përmes masave të miratuara nga shteti në fillim të marsit⁵. Rritje të çmimeve në baza mujore vihet re edhe në komponentin bazë të inflacionit, me rritje më të ndjeshme të çmimeve të shërbimeve të hotelierisë, çmimeve të produkteve jo të qëndrueshme për mirëmbajtjen rutinë të amvisërive, si dhe çmimeve më të larta të transporti rrugor, ndërsa një kontribut negativ ka ulja e çmimeve të transportit ajror.

Shkalla vjetore e inflacionit në mars ishte 8,8% (7,6% në shkurt), me një përshpejtim më të theksuar të rritjes vjetore të çmimeve në komponentin ushqimor. Kontributin më të madh në shkallën vjetore të inflacionit e kanë rritja e çmimeve të bukës dhe produkteve të drithërave, karburanteve, perimeve të freskëta, si dhe çmimi më i lartë i energjisë elektrike që nga fillimi i vitit⁶. Shkalla e inflacionit vjetor e realizuar në mars është mbi shkallën e parashikuar nga cikli i projeksioneve të tetorit, me një devijim në rritje në të tre kategoritë kryesore, por më i theksuar në komponentët energjetike dhe ushqimore.

⁵ Më 9 mars 2022, shteti miratoi një paketë masash për të përballuar krizën energjetike dhe rritjen e lartë të çmimeve. Për të zbutur rritjen e çmimeve të ushqimeve dhe karburanteve, u miratuan këto masa: ulje e normës preferenciale të TVSH-së për produktet ushqimore bazë nga 5% në 0%, e vlefshme nga 17 marsi deri më 31 maj 2022; ngrirja e marzheve tregtare të produkteve ushqimore bazë; ulja e normës së TVSH-së nga 18% në 10% për shitjen e karburanteve: benzinë pa plumb, gaz naftë, gaz të lëngshëm naftë (LPG) dhe metan; dhe ulja e taksës së akcizës bazuar në çmimet e bursës, për të zbutur ndikimin e çmimeve të bursës, të cilat do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në çmimin e karburanteve në pikat e karburantit. Produktet ushqimore bazë përfshijnë këto produkte: bukë, miell tip 400, qumësht me përmbajtje yndyre 2%, 3,2% dhe 3,5%, sheqer të bardhë, vaj luledielli, mish dhe produkte të tjera ushqimore të therjes, oriz të bardhë dhe vezë. Marzhi më i lartë tregtar për produktet ushqimore bazë për të gjitha shoqëritë tregtare dhe tregtarët individualë që marrin pjesë në zinxhirin tregtar në tregtinë me shumicë përcaktohet në një shumë totale deri në 4% të çmimit të shitjes të llogaritur në tregtinë me shumicë, pra në një shumë totale prej deri në 3% të çmimit të shitjes të llogaritur në tregtinë me pakicë. Megjithatë, për shkak të mënyrës së regjistrimit të çmimeve nga EShS (në mes të çdo muaji), masat lidhur me çmimet e ushqimeve do të kishin efekt të plotë në regjistrimin e çmimeve për muajin prill 2022.

⁶ Në përputhje me Vendimin e Komisionit Rregullator të Energjetikës të RMV-së, datë 30.12.2021, çmimi i energjisë elektrike për furnizuesin universal "EVN HOME" SH. P. K Shkup nga 1 janari 2022 rritet për 9,48% (<https://www.erc.org.mk/pages.aspx?id=153>).

Инфлација и цени на храната и енергијата (годишни промени, во %)



Странски ефективни* и домашни цени на храна и безалкохолни пијалаци (индекси, 2015=100)



* Ефективните странски цени на храна се добиени како пондеризиран збир од цените на храната во земјите што се најзначајни трговски партнери на Северна Македонија во доменот на увозот на храна.

Извор: ДЗС, Еуростат и пресметки на НБРСМ.


Shkalla bazë e inflacionit në mars ishte 1% me bazë mujore (0,9% në muajin paraardhës). Në bazë vjetore, shkalla bazë e inflacionit është 5,2% (4,3% në muajin paraardhës), brenda së cilës kontributin më të lartë pozitiv e kanë çmimet e shërbimeve në restorante dhe hotele, të plotësuara nga çmimet e duhanit, ndërkaq në një masë të vogël edhe nga çmimet e produkteve të higjienës personale, pijeve joalkoolike, transportit ajror dhe rrugor, produkteve jo të qëndrueshme për mirëmbajtjen rutinë të amvisërive, si dhe çmimet e automjeteve.

Sa u përket lëvizjeve të pritshme të çmimeve të supozimeve hyrëse të jashtme në projeksionin e inflacionit, rishikimet janë në kahen në rritje, që së bashku me realizimet më të larta se projeksionet, krijojnë rreziqe në rritje për normën e projektuar të inflacionit në vitin 2022. Në të njëjtën kohë, vazhdon të jetë e theksuar pasiguria dhe dinamika e lëvizjes së çmimeve botërore të produkteve primare në periudhën e ardhshme, e cila korrespondon me efektet e pasigurta ekonomike të konfliktit ushtarak në Ukrainë dhe sanksioneve kundër Rusisë të vendosura nga shumica e vendeve në botë, si dhe zhvillimi dhe përballja me pandeminë që vazhdon të ekzistojë.

Në janar të vitit 2022, rritja nominale vjetore e rrogës mesatare neto ishte 6% (5,8% në muajin paraardhës). Rritja e rrogës minimale për 1,7% në prill 2021, në përputhje me rregullimin e rregullt ligjor, kontribuon pjesërisht në rritjen e pagave vjetore⁷.

⁷ Në prill të vitit 2021 u bë harmonizimi i rregullt i rritjes së rrogës minimale (me rritjen e rrogës mesatare të paguar në RMV për vitin paraardhës, indeksit të shpenzimeve së jetesës dhe të rritjes reale të PBB-së – përkatësisht një e treta e rritje në secilin tregues). Sipas njoftimit të Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale, botuar në "Gazetën Zyrtare të RMV-së" nr. 80/21 për zbatimin e Ligjit të Rrogës Minimale në Republikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 11/12, 30/14, 180/14, 81/15, 129/15, 132/17 dhe 140/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 124/19 dhe 239/19), rroga minimale neto është rritur për 260 denarë. Lartësia e rrogës minimale në bruto, duke filluar nga prilli 2021, deri në mars 2022, është 22.146 denarë (më parë 21.776 denarë), pra rroga minimale në shumën neto është 15.194 denarë (më parë 14.934 denarë).

Просечна исплатена месечна нето-плата по сектори




Rritja vjetore e pagave në muajin janar vihet re në të gjitha aktivitetet, me më të theksuara në aktivitetet që kanë të bëjnë me "akomodimin", "veprimtaritë e tjera shërbimi", "tregtinë", "veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike", "bujqësinë", "minierat dhe gurorë" "aktivitetet e shërbimeve administrative dhe ndihmëse", ndërsa rritje solide shënuan edhe pagat në aktivitetet e "informacionit dhe komunikimit", "ndërtimtarisë" dhe "transportit".

Me rritje vjetore të shpenzimeve së jetesës, **në janar 2022 vihet re rënie reale e pagës neto prej 0,6%.**

Shkallët nominale dhe reale vjetore të realizuara të ndryshimit të pagave në janar 2022 janë aktualisht brenda pritshmërive për tremujorin e parë sipas projeksionit të tetorit.


Индикатор на економска доверба и БДП



Të dhënat me frekuencë të lartë për anën e ofertës dhe kërkesës që janë në dispozicion për periudhën janar - shkurt 2022 tregojnë kryesisht për ngadalësim të rritjes vjetore të aktivitetit ekonomik edhe në tremujorin e parë të vitit. Kur bëhet fjalë për perceptimet e subjekteve ekonomike për gjendjen e ekonomisë⁸, rezultatet e hulumtimit të anketës për tremujorin e parë të vitit tregojnë për perceptime paksa më pak të favorshme krahasuar me tremujorin e mëparshëm, të lidhur kryesisht me përhapjen e llojit "omikron" të Kovid-19, si dhe për shkak të përshkallëzimit ushtarak midis Rusisë dhe Ukrainës, përkeqësimi i mëtejshëm tashmë i ndërprerë zinxhirët e furnizimit global dhe tregjet e energjisë. Megjithatë, perceptimet e subjekteve ekonomike janë ende më të favorshme krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, gjë që tregon kryesisht rritje të mëtejshme të ekonomisë, por më të moderuara.

Të dhënat në dispozicion me frekuencë të lartë në kahun e ofertës për tremujorin e parë të vitit tregojnë kryesisht rritje të aktivitetit ekonomik, por më të moderuar krahasuar me rritjen e shënuar në tremujorin e mëparshëm.

⁸ U referohet sondazheve të kryera nga Komisioni European për të matur besimin ekonomik të subjekteve në ekonomi. Treguesi i përbërë i besimit ekonomik përftohet si mesatare e ponderuar e treguesve të besimit për konsumatorët dhe treguesve të besimit për sektorë individualë të ekonomisë (ndërtim, industri, tregti me pakicë dhe shërbime).




Në periudhën janar – shkurt 2022, **qarkullimi në totalin e tregtisë** vazhdon të shënojë rritje reale vjetore solide, e cila vjen si pasojë e rritjes në të tre llojet e tregtisë (tregtia me shumicë, tregtia me pakicë dhe tregtia e automjeteve).

